

William R. Hite, Jr., Ed.D.
Superintendent

21 Dhjetor , 2021

Të Nderuar Prindër dhe Familje të Drejtorisë Arsimore të Filadelfias,

Se pari dua t'ju *falënderoj* për gjithçka që keni bërë për të mbështetur shkollat tona pasi ne i kemi mirëpritur nxënësit përsëri në mësimin në - person këtë vit shkollor. Për afro dy vjet, të rinjtë tanë kanë përjetuar situata të paimagjinueshme. Rrethimi i tyre me edukatorë të kujdesshëm dhe mbështetje sociale dhe emocionale në mjedise të sigurta dhe familjare shkollore është një pjesë jetike për t'i ndihmuar ata në këto kohë të veshtira. Ne mbetemi të përkushtuar për t'i mbajtur dyert e shkollave tona të hapura - për *aq kohë sa mund ta bëjmë këtë në mënyrë të sigurtë*.

Ndërsa sezoni i festave afrohet dhe variantet e reja si Delta dhe Omicron evoluojnë, ne të gjithë duhet të jemi tepër vigjilentë për të bërë pjesën tonë për të ndihmuar të mbajmë veten dhe ata përreth nesh të sigurtë. Ja çfarë mund të bëjë secili prej nesh për të kufizuar përhapjen e koronavirusit dhe për të mbështetur shkollat tona:

✓ **Bëni një vaksinë kundër gripit dhe vaksinën ose përforcuesin/booster të COVID-19** nëse nuk e keni bërë ende. Vaksina tani është e disponueshme për të gjithë pesë vjeç e lart. Vizitoni www.vaccines.gov për të gjetur një vend vaksine pranë jush. Ose telefononi 215-685-5488 nëse keni pyetje rreth vaksinimit.

✓ **Vini një maskë** që mbulon hundën dhe gojën kur jeni në vende të brendshme publike dhe jashtë ku ka rrezik të lartë të transmetimit të COVID-19, si ngjarje të mbushura me njerëz ose tubime të mëdha. Për sigurinë e të gjithëve, duke filluar nga Janari, nxënësit dhe personeli që nuk respektojnë kërkesat për vendosjen e maskave në shkolla do të dërgohen në shtëpi gjatë ditës.

✓ **Testohuni, është falas** - ne po u kërkojmë të gjithëve në shkollat dhe zyrat tona të testohen përpara se të kalojnë kohë me familjen dhe miqtë gjatë festave dhe përpara se të ktheheni në shkolla për t'u siguruar që jeni pa COVID kur të rihapim, veçanërisht nëse keni simptomat e COVID-19 ose keni pasur kontakt të ngushtë me disa që kanë COVID-19. Për ta bërë më të lehtë, të gjitha zonat e testimit të SDP-së do të qëndrojnë të hapura për testimin e personelit dhe studentëve nga ora 9:00am-18:00pm, nga e Hëna deri të Premte gjatë pushimeve dimërore :

- South Philadelphia High School (2101 S. Broad St)
- Samuel Fels (5500 St. Langdon)
- Overbrook High School (5898 Lancaster Ave)

- MLK High School (6100 Stenton Ave)
- Thomas Edison High School (151 West Luzerne St)
- Northeast High School - new (1601 Cottman Ave, corner of Glendale and Bleigh Ave).

Si gjithmonë, ju lutemi qëndroni në shtëpi nëse rezultoni pozitiv dhe raportoni çdo rast pozitiv ne “ COVID Response Team” në koronavirusreport@philasd.org.

Në pritje të vitit 2022, pa dyshim që do të përballemi me vështirësi dhe pasiguri të reja që do të kërkojnë që të gjithë ne të jemi fleksibël. **Në këtë kohë, ne po planifikojmë të rifillojmë mësimin e plotë në - person kur shkolla të rifillojë për studentët të Martën, 4 Janar 2022.** Megjithatë, nëse rastet e COVID rriten gjatë festave, ne mund të marrim udhëzime të reja nga Departamenti i Shëndetit Publik të Filadelfias (PDPH). Ne do të vazhdojmë të ndjekim udhëzimet e PDPH për funksionimin e shkollës dhe do t'ju mbajmë të informuar për çdo ndryshim.

Si kujtim, të gjitha shkollat dhe zyrat administrative të Drejtorisë Arsimore do të jenë të mbyllura nga 24 Dhjetor deri më 2 Janar. Ne e dimë se kjo periudhë e vitit mund të jetë veçanërisht e vështirë për shumë njerëz. Ju lutemi vizitoni phila.gov për të gjetur vendet e shpërndarjes së vakteve të ushqimit në Filadelfia ose telefononi Philly Hopeline në 1-833-PHL-HOPE nëse ju ose fëmija juaj dëshironi shërbime këshillimi falas.

Nga familja ime tek e juaja, ju uroj festime të gëzueshme dhe të sigurta, dhe një Vit të Ri të mbarë! Shihemi në vitin 2022.

Sinqerisht,



William R. Hite Jr., Ed.D.
Superintendent
Drejtoria Arsimore e Filadelfias